



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.22/2018
Prishtinë, më 29.3.2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari-Lila, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Mungoi: Dardan Molliqaj, anëtar.

Të ftuar: Arsim Janova, u.d. kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE; Ilir Shala, kryeshef i Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut - KOSTT.

Pjesëmarrës të tjerë: Besim Sejfiqaj, Izet Rushiti, Selman Hoti, Petrit Pepaj, Adelina Murtezaj – ZRRE; Kadri Kadriu, Visar Hoxha – KOSTT; Dardan Abazi – INDEP; Amire Qamili - BIRN; Egzon Osmanaj, Jeta Krasniqi, Adelina Hasani – KDI, dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 27.3.2018;**
3. **Raportim i institucioneve përkatëse për fushën e energjisë, të ftuar përfaqësuesit e ZRRE-së dhe KOSTT-it;**
4. **Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.3.2018.

Procesverbali nga mbledhja e datës 27.3.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i institucioneve përkatëse për fushën e energjisë, të ftuar përfaqësuesit e ZRRE-së dhe KOSTT-it;

Sala Berisha-Shala, kryetare, njoftoi për vizitën e bërë në KOSTT, së bashku me deputeten Mimoza Kusari-Lila, për të parë zbatimin e marrëveshjeve me Serbinë për sektorin e energjisë, ngase sië tha ka ngecje në zbatimin e marrëveshjeve dhe për këtë arsye janë ftuar sot këto dy institucione përgjegjëse në fushën e energjisë, të raportojnë para Komisionit dhe të sqarojnë se ku kemi progres e ku ngecje dhe cilat janë pengesat. Ne, shtoi ajo, kemi parë në media se Qeveria ka ndarë një milion euro për KOSTT-in dhe të sqarohet pse janë dhënë.

Mimoza Kusari-Lila, kërkoi prej përfaqësuesve të ZRRE-së, që të fokusohen në një përgjigje. Kuvendi i Republikës së Kosovës me 9 shkurt 2018, ka nxjerrë disa rekomandime për ZRRE-në. Cilat janë masat që janë marrë në drejtim të zbatimit të rekomandimit të Kuvendit për kompensimin e konsumatorëve, të cilët padrejtësisht janë faturuar për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunitat veriore të Kosovës? A ka në Ligjin e Energjisë humbje të deklaruara si humbje politike, çfarë kategorizimi është humbje politike? Përfaqësuesit e KOSTT-it të na tregojnë se si do të jetë situata energjetike pas 31 marsit 2018, dhe a kanë pasur ndonjë komunikim tjetër me Qeverinë, në lidhje me mënyrat e kompensimit të mëtutjeshëm të pagesës së rrymës në veri? A do të jetë 1 prilli 2018, datë e krizës tjetër për KOSTT-in apo është duke u menaxhuar situata?

Arsim Janova, ZRRE, theksoi se prej muajit nëntor, jemi përballur me probleme të furnizimit me energji elektrike. Fillimisht me prodhim të energjisë nga KEK-u, pastaj pas vendimit gjyqësor të gjykatës për masë të përkohshme prej 1 dhjetorit 2018. Ne kemi qenë të detyruar ta zbatojmë vendimin e gjykatës dhe janë zvogëluar faturat për 3.5%. Kjo pjesë i është ngarkuar KOSTT-it. KOSTT-i në mungesë të buxhetit për me ble energji elektrike e ka tërheq energjinë elektrike nga interkoneksioni ndërkombëtar. Pas këtij veprimi ENTSO-E i ka dhënë ultimatum që deri më 1 mars 2018, të ndërpritet tërheqja e energjisë nga interkoneksioni ndërkombëtar. Në këtë situatë KOSTT-i ka bërë kërkesë në Qeveri që të ndahen një milion euro për të mbuluar shpenzimet në veri për muajin mars. Obligimet e KOSTT për tre muajt e kaluar janë borxh për interkoneksionin ndërkombëtar. Sa i përket procesit tarifor, me 1 prill të këtij viti do të duhej të hyjë tarifimi i ri pesëvjeçar, por për shkak të mungesës së bordit nuk patëm mundësi të vazhdojmë konsultimin publik. Të gjitha përgatitjet për procesin e ri tarifor janë kryer nga stafi i ZRRE-së. Tani, pasi që është plotësuar bordi, na duhen rreth dy muaj të përfundojmë procesin e ri tarifor. Duhet të sqarohet nga Qeveria se çka do të bëhet me shpenzimet e veriut, në mënyrë që të përfundohet procesi tarifor. Sa i përket kompensimit të konsumatorëve për periudhën që

kanë paguar për shpenzimet në veri, jemi duke biseduar me Qeverinë. Procesi është mjaft kompleks, dhe jemi në përpjekje të gjetjes së zgjidhjes për këtë çështje.

Illir Shala, KOSTT, duke u përgjigjur në pyetje, theksoi se ne kemi bërë kërkesë në Qeveri që të ndahet buxhet për muajin prill. Me kërkesë të ministrit të MZHE-së, ne do të bëjmë një plan për shpenzimet për katër muajt e ardhshëm dhe do të kërkojmë nga Bashkësia Evropiane të bartë shpenzimet e veriut.

Hykmete Bajrami, pyeti se a ka ZRRE-ja evidencë që gjatë gjithë periudhës, pjesa veriore është furnizuar nga Kosova e jo nga Serbia? Kemi dëgjuar se “Elektroprivreda” ka faturuar atje në pjesën veriore, a keni informata për këtë? A mund ta sqaroni tërheqjen e energjisë nga interkoneksioni ndërkombëtar? Sa i përket kompensimit të konsumatorëve, kjo nuk duhet me ndodhë nga buxheti i Kosovës, sepse edhe këto mjete janë të qytetarëve të Kosovës, por të gjenden mënyra tjera për kompensim, duke parë si mundësi edhe fondin zhvillimor për veriun.

Arsim Janova, ZRRE, sqaroi se ne e dimë sa e ka furnizuar Kosova dhe për këtë kemi evidencë, ndërsa se a e ka furnizuar edhe Serbia për këtë nuk kemi evidencë, nuk kemi burime. Sa i përket faturimit në pjesën veriore, kemi fakte se ka faturim por nuk dihet niveli i faturimit. Në pjesën veriore është një kompani që e mirëmban rrjetin e energjisë elektrike. Kostoja vjetore për veriun është 10 milionë euro në vit. Për të mundësuar faturimin në pjesën veriore, shteti duhet të krijojë kushtet për operim në atë pjesë.

Illir Shala, KOSTT, sqaroi se prej 2 dhjetorit 2017, KOSTT-i nuk ka blerë energji për furnizim në veri për shkak të vendimit të gjykatës. ZRRE-ja shpenzimet e veriut ja ka ngarkuar KOSTT-it. Andaj, për të furnizuar veriun me energji, KOSTT-i ka tërhequr energji nga interkoneksioni ndërkombëtar sepse nuk kemi mundur të blejmë energji në mungesë të mjeteve financiare. Një pjesë të energjisë të tërhequr nga interkoneksioni ndërkombëtar do ta kthejmë, duke blerë tepricat nga KEK-u. KEK-u nuk ka prodhuar mjaftueshëm që të marrim nga KEK-u. Ne kemi marrë letër nga ENTSO-E që të ndërpritet tërheqja e energjisë nga interkoneksioni ndërkombëtar sepse po çrregullohet transmetimi i energjisë elektrike. Zgjidhja e këtij problemi është të ndahet buxhet nga Qeveria. Nëse nuk e ndërpresim tërheqjen e energjisë nga interkoneksioni ndërkombëtar, rrezikojmë të na ndërpritet linja interkonektive dhe Kosova të mbetet në terr, sepse as blloqet e termocentraleve të Kosovës nuk mund të startojnë pa linjë interkonektive. Sa i përket kthimit të energjisë së tërhequr, kjo energji nuk do të paguhet por do të kthehet energji për energji, mirëpo, për me blerë energji që të kthehet duhet me pasur mjete financiare.

Dardan Sejdiu, pyeti se a ka filluar ky problem energjetik me vendimin e gjykatës? Ky vendim për zvogëlimin e faturave për 3.5%, kur është marrë dhe kur është futur në faturë? Cili është modeli që i keni propozuar Qeverisë për të paguar këtë dallim?

Kryetarja, potencoi se penaltitë nga interkoneksioni ndërkombëtar po bëhen direkt për Kosovën, derisa KOSTT-i nuk është anëtar i plotë i ENTSO-E. Kurse Serbia nuk ndëshkohet për shkak të tërheqjes së energjisë elektrike nga Kosova, mirëpo, përfitimet për interkoneksionin e Kosovës i merr Serbia, e jo Kosova. Ky është një kompleks i problemeve dhe kryesisht lidhen me marrëveshjet politike, të cilat nuk po zbatohen nga Serbia.

Duda Balje, iu drejtua përfaqësuesëve të ZRRE-së duke ju thënë se nuk po e sqaroni pse gjykata ka marrë masa, dhe potencoi se janë shkelë të drejtat e qytetarit sepse kanë paguar për diçka që nuk kanë shpenzuar. “Elektroprivreda Serbia” ka dy firma në veri, qytetarët thonë që kanë paguar energjinë. Qeveria ka angazhuar një ekspert gjerman për të analizuar si të dilet nga kjo situatë.

Ilir Shala, KOSTT, theksoi se faturimin dhe inkasimin e ka KESCO-ja, ndërsa KOSTT-i vetëm ka zbatuar vendimet e ZRRE-së.

Arsim Janova, ZRRE, theksoi se a ka qenë vendim i ligjshëm i ZRRE-së, do të vendosë gjykata. Problemin tash në dorë e ka Qeveria dhe Kuvendi. Ne si rregullator vetëm e zbatojmë ligjin.

Mimoza Kusari-Lila, pyeti se a ka mundësi Kosova të vazhdojë me u përballu me humbjet e mosfaturimit të rrymës në veri? A jeni duke u përballuar me një krizë imediate energjetike, me një shkatërrim të reputacionit të KOSTT-it dhe Kosovës para komunitetit të energjisë të Evropës?

Gani Dreshaj, theksoi se kërkohet kompetencë prej të gjithëve të gjejnë zgjidhje. Sa kam informacion, Qeveria ka filluar angazhimet të gjejë një zgjidhje. Më intereson se ku mbeti 44% të energjisë që kam paguar për shtetin? Rregull ka mundësi të vendoset nëse ka një angazhim të udhëheqësve të KOSTT-it, ZRRE-së dhe Qeverisë.

Arsim Janova, ZRRE, theksoi se KOSTT-i janë dëmtuar për 44%, sepse ajo 3.5% që hiqet prej faturave për shkak të veriut, në një mënyrë përbën 44% të të hyrave nga rrjeti i KOSTT-it, jo nga të hyrat nga konsumatorët. Për pjesën e negociatave që bëhen në Bruksel, ne si rregullator nuk jemi pjesë e atij procesi dhe nuk mund të japim ndonjë përgjigje.

Ilir Shala, KOSTT, sqaroi se KOSTT-i nuk është kompani që bënë faturimin dhe inkasimin, këtë përgjegjësi e ka KESCO-ja.

Duda Balje, pyeti sa jemi të penguar si Kosovë nga Serbia në tregun energjetik të Evropës? Kërkesë për regjistrim ka bërë kompania nga veriu, por është refuzuar për shkak se nuk ka qenë në përputhje me ligjin e Kosovës.

Ilir Shala, KOSTT, potencoi se Serbia po bënë obstrukcion për zbatimin e marrëveshjes. Me marrëveshje ka qenë që “Elektroserver” të regjistrohet sipas ligjeve të Kosovës.

Hykmete Bajrami, sqaroi se kompania nga veriu ka aplikuar disa herë, por jo në përputhje me marrëveshjen dhe me ligjet e Kosovës në ARBK. Ajo kërkoi, që në një të ardhme, të ftohet ministri i MZHE-së, që të sqarojë përgjegjësinë e KEDS-it për komunat veriore sipas kontratës së privatizimit.

Ilir Shala, KOSTT, sqaroi se nga takimi i fundit në Bruksel me delegacionin nga Serbia nuk ka rezultuar me ndonjë progres. E vetmja zgjidhje është të regjistrohet “Elektroserver” në

përputhje me ligjet e Kosovës në ARBK. Serbia, për transmetimin ndërkombëtar të energjisë në linjat interkonektive të Kosovës, merr rreth 9.7 milion euro në vit dhe deri tash është arritur vlera prej 52 milionë euro.

Arsim Janova, ZRRE, theksoi se ne si ZRRE nuk e kemi pa kontratën e privatizimit të KEDS-it. KEDS-i e ka licencën për tërë territorin e Kosovës.

Hykmete Bajrami, pyeti se a ka ndonjë mundësi për me marrë masa për ta detyruar Serbinë që ta zbatojë marrëveshjen? A ka mundësi me e ndërpre marrjen e milionave nga Serbia për interkoneksionin e Kosovës?

Ilir Shala, KOSTT, u përgjigj se nuk ekziston ndonjë mundësi e tillë.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të vazhdojë të ftojë përfaqësuesit e ZRRE-së dhe KOSTT-it, që të informohen lidhur me ecurinë e zbatimit të marrëveshjes për energji me Serbinë dhe për masat e ndërmarra për tejkalimin e sfidave që ndërlidhen me faturimin dhe inkasimin në veri.

4. Të ndryshme.

Çështjet vijuese

Sala Berisha-Shala, kryetare, njoftoi anëtarët e Komisionit se nesër do të mbahet mbledhje e Komisionit, ku do të shqyrtohet raporti me rekomandime për Projektligjin për metrologji dhe për Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, si dhe në rend dite do të jetë edhe shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për anëtarë të bordit të AKP-së.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetares.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA
